



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM

Nr 130 Datë 27.11.08

PER

**Pjesmarrjen e Korit "LIRA" në edicionin e III-të të Festivalit Ndërkombëtar
"Imazhi Shqiptar" në Botë**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, me propozim të këshilltarëve lidhje me « **Pjesmarrjen e Korit "LIRA" në edicionin e III-të të Festivalit Ndërkombëtar "Imazhi Shqiptar" në Botë** », bazuar në ligjin nr. mbi 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr.9836 dt. 26.11.2007 « Per buxhetin e Shtetit te vitit 2008 », Udhezimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F « Per zbatimine buxhetit te shtetit per vitin 2008 ».Udhezimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrise se Brendshme « Per zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2008 », V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 « miratimin e buxhetit te Bashkise dhe institucioneve te vartesise per vitin 2008 », Ligji nr. 9936 date 26.06.2008 « Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise » mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratoje kontributin financiar të Bashkisë me vlerën prej 160,000 lekësh për « Pjesmarrjen e Korit "LIRA" në edicionin e III-të të Festivalit Ndërkombëtar "Imazhi Shqiptar" në Botë" sipas zërave të mëposhtëm:

Kosto për një autobus

- Shpenzime udhëtimi

60,000 lekë

- Shpenzime diete

50 persona x 2,000 lekë = 100,000 lekë

Shuma

160,000 lekë

2. Ky fond do të përballohet nga fondi i shpenzimeve operative të Bashkisë dhe N.SH.M.A.C. me kete strukture buxhetore :

Pakësohet	00	01110	05	Art	6020000	- 40.000 lekë Bashkia
Pakësohet	00	09120	05	Art	6020000	-120.000 lekë N.SH.M.A.C.
Shtohet	00	08250	05	Art	6020000	+160.000 lekë Q. Ek.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, N.SH.M.A.C. dhe Qendra ekonomike e Kulturës " Vangjush Mio".

4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase

Raimonda Nase